EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8442
E shtunë, 28 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Zbulohet pllaka përkujtimore në shtëpinë e Sabit Gecit në Llaushë, në prag të 29-vjetorit të daljes publike të UÇK-së

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FSK-ja SHËNON 27 NËNTORIN - "DITËN E FORCËS" -
ME AKTIVITETE NË TË GJITHA KAZERMAT

KOSOVA SHËNON DITËN E USHTRISË

FAQE 4-5



Kazerma "Adem Jashari" të premten ishte plot me qytetarë dhe fëmijë. Me rastin e "Ditës së Forcës", ata vizituan njësitë e FSK-së, biseduan me pjesëtarët e saj dhe u njohën nga afër me pajisjet dhe kapacitetet e tyre. Të pranishëm në këtë ditë ishin edhe udhëheqësit e lartë shtetërorë, të cilët theksuan se ushtria e sotme e Kosovës nuk mund të kuptohet jashtë historisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata u zotuan që do ta rritin përkushtimin për forcimin e ushtrisë, avancimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe mbështetjen e pjesëtarëve të saj

KURTI NË TIRANË: KOSOVA I KA PËRMBUSHUR MARRËVESHJET E MOBILITETIT, KËRKON STATUSIN E KANDIDATIT NË BE

F. 3



SHIROKA PULA NË OHËR: KOSOVA NUK KËRKON PRIVILEGJ, POR BARAZI DHE RESPEKT NË RRUGËN DREJT BE-së

F. 7



AKTUALE



TRUMPI I KËRKON PUTINIT TË "TËRHIQET" NGA AGRESIONI NË EVROPË, TEKSA SHBA-JA SHTYN RISHIKIMIN E PRANISË USHTARAKE F. 2

THAÇI, VESELI, SELIMI DHE KRASNIQI SHPALLEN "NDERI I SHOQATËS SË TË BURGOSURVE POLITIKË TË KOSOVËS" F. 3

EDHE DY BANKA NISIN ZBATIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE TË SHPEJTA NË KOSOVË TIPS-k F. 6

EKONOMI



NDËRTIMI NË KOSOVË VAZHDON TË SHTRENJTOHET, RRITEN KOSTOT E TRANSPORTIT, PAGAVE DHE MATERIALEVE F. 8

SPORT



SHORT "FERRI" PËR SHQIPËRINË NË EURO U21, DUKA E QUAN HISTORIK ORGANIZIMIN F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

TRUMPI I KËRKON PUTINIT TË "TËRHIQET" NGA AGRESIONI NË EVROPË, TEKSA SHBA-ja SHTYN RISHIKIMIN E PRANISË USHTARAKE

UASHINGTON, 27 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump i bëri thirrje presidenti rus Vladimir Putin ta ndalë të gjithë agresionin ushtarak në Evropë dhe t'i hapë rrugë një marrëveshjeje paqeje për Ukrainën, teksa Uashingtoni po shtyn afatin për një rishikim të pranisë së tij ushtarake në kontinent.

Në një postim në "Truth Social", Trumpi shkroi se gjatë bisedimeve të fundit në Kinë me Putinin, i ka kërkuar liderit rus të "tërhiqet nga i gjithë agresioni ushtarak kundër territoreve në mbarë Evropën, me shpresën se mund të arrihet një marrëveshje mes Rusisë dhe Ukrainës, dhe të arrihet shpejt".

Duke e përshkruar konfliktin si një "gjakderdhje" që vret mijëra njerëz çdo muaj, Trumpi, në postimin e 26 nëntorit, mbajti një qëndrim më të ashpër ndaj Moskës, vetëm disa ditë pasi u kritikua për shkak se e cilësoi Putinin si "miku im".

Duke folur me gazetarët dhe pjesëtarët e ushtrisë amerikane më vonë më 26 nëntor, Trumpi e mbrojti ndryshimin e retorikës së tij si një taktikë pragmatike negociuese, teksa pranoi se një natë më parë kishte diskutuar "gjatë" për dislokimin e forcave në Evropë me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në resortin e tij Mar-a-Lago në Florida. "Kam qenë shumë i ashpër ndaj Rusisë, por dua të arrij një marrëveshje", tha Trumpi duke argumentuar se raportet personale janë thelbësore.

Kur u pyet nëse do të reduktojë rreth 80 000 trupa amerikane të stacionuara në Evropë - kryesisht në Gjermani, Itali dhe Mbretëri të Bashkuar - Trumpi theksoi se ndonëse aleatët evropianë fillimisht "nuk ndihmuan" lidhur me Iranin, përparimi i fundit për Grenlandën, mbështetja e shtuar e NATO-s në Iran dhe zotimet e aleancës për t'i rritur shpenzimet e mbrojtjes drejt pesë për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe për të blerë 750 aeroplanë luftarakë F-35 "më bëri të ndihem pak më ndryshe".

ShBA-ja ka edhe trupa në Kosovë, në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR. Uashingtoni veçse ka paralajmëruar se do të ketë ndryshime në kontributin e tij në KFOR, ndërsa në qershor Komanda Evropiane e ShBA-së konfirmoi se do ta përshtatë gradualisht kontributin amerikan në mision në përputhje me planet e NATO-s.

Ndërkohë, zëvendësambasadori i ShBA-së në NATO, Scott Oudkirk, i informoi diplomatët e vendeve aleate gjatë një takimi me dyer të mbyllura në Bruksel këtë javë se Uashingtoni do ta shtyjë publikimin e rishikimit të dislokimit të forcave amerikane në Evropë përtej 1 dhjetorit, siç ishte planifikuar më herët.

Zyrtarë të lartë amerikanë, të cilët folën për Radion Evropa e Lirë më 26 nëntor në kushte anonimiteti, pasi nuk ishin të autorizuar të diskutonin publikisht për këto çështje, thanë se Pentagoni po finalizon pesë opsione të veçanta - secili i shoqëruar me një vlerësim formal ushtarak që përfshin kontributin e komandantit suprem të Forcave Aleate në Evropë të NATO-s - të cilat së shpejti do t'i paraqiten Trumpit.

Zyrtarët thanë se nuk mund ta thonë nëse vendimi përfundimtar do të shpallet para samitit të ardhshëm të G20-s që do të mbahet në Florida, në të cilën, sipas Trumpit, presidenti rus është i mirëpritur që të marrë pjesë.

Vlerësimi i ofertave të aleatëve dhe ndryshimi i prioriteteve

Një nga faktorët kryesorë që ka nxitur shtyrjen e rishikimit është se Uashingtoni ende po vlerëson ofertat e aleatëve evropianë për të ofruar kapacitete që mund të zëvendësojnë ato të forcave dhe pajisjeve aktuale amerikane, sipas diplomatëve të NATO-s që janë informuar lidhur me takimet e mbajtura këtë javë në Bruksel me përfaqësuesit e vendeve anëtare të aleancës ushtarake perëndimore.

Javën e kaluar në Bruksel, zëvendëssekretari amerikan i Mbrojtjes, Elbridge Colby, tha se shpreson se do të arrihet objektivi i 1 dhjetorit për t'ia dorëzuar raportin përfundimtar sekretarit të Mbrojtjes, Pete Hegseth, duke lavdëruar "përparimin e jashtëzakonshëm" të vendeve, përfshirë Gjermaninë, Poloninë, Holandën dhe shtetet skandinave, për rritjen e shpenzimeve për mbrojtje.

Colby ka vizituar së fundi Rumaninë, Poloninë dhe Gjermaninë për ta përgatitur terrenin për ristrukturimin, të cilin Hegseth e nisi në qershor për ta shqyrtuar numrin e trupave, të drejtat për përdorimin e bazave dhe lejet për fluturime mbi territorin e shteteve, ndërsa Uashingtoni po zhvendos fokusin drejt Indo-Paqësorit dhe hemisferës perëndimore.

Megjithatë, presionet më të gjera politike dhe operacionale e kanë ndërlikuar afatin kohor për rishikim. Aleatët veçse kishin parashikuar një vonesë për shkak të turbulencave politike me të cilat u përball Hegseth, përkatësisht me përpjekjen e pasuksesshme të Kongresit për ta shkarkuar atë pas zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA.

Në të njëjtën kohë, operacionet



ushtarake të ShBA-së kundër Iranit dhe negociatat e ardhshme me Rusinë për Ukrainën kanë nxjerrë në pah kompleksitetin strategjik të ndryshimit të arkitekturës së sigurisë në Evropë.

James Batchik, zëvendësdrejtor i Qendrës për Evropën në Këshillin Atlantik, i tha "Radios Evropa e Lirë" se, ndonëse nuk është e qartë se cilët faktorë burokratikë, politikë dhe operacionalë kanë ndikuar në shtyrje, kjo nuk e ndryshon objektivin kryesor të administratës amerikane. "Unë nuk mendoj domosdoshmërish se kjo shtyrje e ndryshon transformimin strukturor që administrata synon të realizojë në aspektin e sigurisë evropiane", tha Batchik. "Mendoj se rishikimi i dislokimit të forcave është në të vërtetë përkthimi operacional i këtij koncepti të NATO-s 3.0 që po shohim".

Batchik tha se stili i paparashikueshëm i vendimmarrjes së Trumpit u jep kryeqyteteve evropiane arsye për të mbetur të kujdesshme, duke përmendur veprime të ndërmarra tashmë, siç është tërheqja e një brigade këmbësorie amerikane nga Rumania pa e zëvendësuar të njëjtën dhe zhvendosja e planifikuar e 5 000 trupave nga Gjermania në Poloni.

Megjithatë, ai shtoi se operacionet amerikane në Iran i kanë kujtuar Uashingtonit varësinë e tij nga bazat evropiane dhe të drejtat për fluturime mbi territorin e shteteve, duke u ndeshur me thirrjet për një tërheqje të gjerë. "Evropa duhet t'i vëzhgojë nga afër këto vendime dhe këto pesë opsione", tha Batchik, duke u bërë thirrje aleatëve që të vazhdojnë t'i shndërrojnë buxhetet më të larta të mbrojtjes në "kapacitete strategjike mbështetëse" konkrete, të cilat Evropës mund t'i duhet që t'i sigurojë vetë së shpejti.

Ruajtja e parandalimit gjatë tranzicionit

Edhe pse Uashingtoni këmbëngul se angazhimi i tij për sigurinë evropiane mbetet i pandryshuar, mundësia e reduktimit të pranisë amerikane ka nxitur shqetësime në krahun lindor të NATO-s lidhur me parandalimin e Rusisë.

Tsiporah Fried, bashkëpunëtore e lartë në Institutin Hudson, i tha "Radios Evropa e Lirë" se rreziku kryesor është "mospërputhja mes ritmit të reduktimit të forcave amerikane dhe aftësisë së Evropës për t'i zëvendësuar kapacitetet përkatëse". Teksa aleatët evropianë po rritin shpenzimet e mbrojtjes, Fried vuri në pah se shndërrimi i parave në personel të trajnuar, mbrojtje ajrore dhe rezerva municionesh kërkon vite kohë. "Forcat amerikane në Evropë nuk ofrojnë vetëm kapacitete ushtarake: ato e garantojnë përfshirjen e ShBA-së në mbrojtjen e kontinentit, ndërsa prania e tyre konvencionale kontribuon në besueshmërinë e garancisë bërthamore amerikane", tha Fried. "Ajo e përforcon ndërveprueshmërinë dhe siguron që angazhimi i ShBA-së për sigurinë evropiane të mos jetë vetëm politik, por edhe operacional".

Fried paralajmëroi se Rusia veçse po e teston aleancën pothuajse çdo ditë, por nën pragun e konfliktit të armatosur, duke përmendur në këtë drejtim shkeljet e fundit të hapësirës ajrore polake nga Rusia gjatë stërvitjes Koalicja - një stërvitje që bashkon forcat evropiane të cilat po përgatiten për një mision të mundshëm në Ukrainë - si një provokim i qëllimshëm. "Moska po e teston në kohë reale vendosmërinë, bashkëpunimin dhe qëndrueshmërinë e aleatëve. Ajo do ta vlerësojë NATO-n jo nga zotimet për shpenzime në të ardhmen, por nga forcat, kapacitetet dhe gatishmëria që mund të dislokojë sot", tha ajo.

Në vend që të përqendrohen vetëm te numri i përgjithshëm i trupave, Fried argumentoi se aleatët duhet të shqyrtojnë se cilat kapacitete specifike do të mbeten dhe ku do të dislokohen - veçanërisht kapacitetet që është e vështirë të zëvendësohen, si inteligjenca, mbrojtja ajrore, logjistika dhe infrastruktura për përforcime të shpejta.

Ajo shtoi se një reduktim i kufizuar i trupave, i shoqëruar me zhvendosjen e tyre nga Gjermania drejt aleatëve lindorë, si Polonia, mund ta forcojë NATO-n nëse bëhet në mënyrë të duhur. "Shtyrja e afatit fillestar u jep Uashingtonit dhe aleatëve të tij më shumë kohë për t'i vlerësuar alternativat, implikimet e tyre ushtarake dhe ritmin me të cilin evropianët mund të marrin përsipër përgjegjësi shtesë", tha Fried. "Kjo është një mundësi për të siguruar që tranzicioni të bazohet në realitetet operacionale dhe jo thjesht në objektiva politike apo numerike". Takimi i ministrave të jashtëm të NATO-s në Bruksel, që do të mbahet javën e ardhshme, pritet t'u ofrojë diplomatëve të vendeve aleate një mundësi për të diskutuar ecurinë e rishikimit, edhe pa pasur propozime zyrtare në tryezë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KURTI NË TIRANË: KOSOVA I KA PËRMBUSHUR MARRËVESHJET E MOBILITETIT, KËRKON STATUSIN E KANDIDATIT NË BE

Të premten në Tiranë është mbajtur Samiti i gjashtë i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Kryeministri Albin Kurti së bashku me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, përfaqësuesit e vendeve të rajonit dhe komisionaren evropiane për zgjerim, Marta Kos, kanë diskutuar për ecurinë e reformave dhe procesin e integrimit evropian

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



TIRANË, 27 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të premten në Tiranë në Samitin e gjashtë të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, ku është diskutuar për reformat dhe integrimin gradual të vendeve të rajonit në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian.

Përmes një deklarimi, Kurti ka bërë me dije se në këtë samit, së bashku me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, përfaqësuesit e vendeve të rajonit dhe komisionaren evropiane për zgjerim, Marta Kos, kanë diskutuar për ecurinë e reformave dhe procesin e integrimit evropian.

Kurti ka thënë se zgjedhjet e përsëritura në Kosovë kishin ngadalësuar ritmin e reformave, por ka theksuar se me stabilitetin institucional është përshpejtuar dinamika e zbatimit të tyre. "Do t'i përmbushim të gjitha, edhe ato për të cilat fondet humbën, sepse reformat janë detyrë e jona kombëtare dhe evropiane", ka deklaruar Kurti.

Ai ka përmendur edhe marrëveshjet e mobilitetit, duke theksuar se Kosova i ka ratifikuar të pesë marrëveshjet, ndërsa ka kritikuar Serbinë për mosnjohjen e diplomave të Kosovës. Sipas tij, bashkëpunimi rajonal nuk duhet të pengohet nga bllokadat dhe përfitimi nga fondet e Bashkimit Evropian duhet të lidhet me zbatimin e marrëveshjeve të dakorduara. "Kush zbaton më shumë nga ajo që është dakorduar, duhet të përfitojë më shumë nga fondet e BE-së", ka theksuar Kurti.

Në fund, kryeministri ka ritheksuar kërkesën e Kosovës për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ai ka thënë se këtë kërkesë e paraqet në çdo takim, duke vlerësuar se qytetarët e Kosovës kanë mbështetje të lartë për integrimin evropian. "Kosova e ka fituar këtë hap me meritë. Ka qenë gjithmonë e rëndësishme, tani është urgjente", ka përfunduar Kurti.

Kos: Shqipëria mund ta përmbyllë procesin e negociatave për anëtarësim në BE deri në vitin 2030

Shqipëria mund ta përmbyllë procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030. Ky ishte mesazhi i komisionares evropiane për zgjerim, Marta Kos, gjatë samitit të zhvilluar në Tiranë për Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, ku u diskutua për ecurinë e vendeve të rajonit drejt integrimit evropian dhe përmbushjen e reformave të kërkuara nga BE-ja.

Kos vlerësoi përparimin e Shqipërisë dhe Malit të Zi, të cilat, sipas saj, kanë përfituar më shumë fonde nga Plani i Rritjes si rezultat i përmbushjes së detyrimeve dhe reformave të përcaktuara. Ajo theksoi se rruga drejt Bashkimit Evropian do të jetë e hapur për çdo vend të Ballkanit Perëndimor, por përparimi do të vlerësohet në bazë të meritave dhe rezultateve konkrete.

Komisionarja evropiane u ndal edhe te perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë, duke deklaruar se vendi mund ta nënshkruajë traktatin e anëtarësimit në vitin 2028. Megjithatë, ajo theksoi se përmbushja e reformave dhe vijimi i përparimit mbeten vendimtare për realizimin e këtij objektivi. "Sa iu përket udhërrëfyesve që ne kemi ofruar dhe në raportin e sivjetshëm, ne kemi thënë që Shqipëria mund t'i përmbyllë të gjithë kapitujt për negociata në qoftë se do të ketë rezultate të reformave dhe sigurisht dhe në rast se shtetet anëtare do ta japin dritën e gjelbër për Shqipërinë dhe në qoftë se ndodhin këto gjëra, rreth kësaj kohe ne mund të jemi shumë pranë fundit të negociatave. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që hapi i mëtejshëm do të jetë që rreth gjysma e kapitujve të mbyllur, do të thotë që shtetet anëtare do ta krijojnë grupin e punës për traktatin e anëtarësimit, i cili, po flas që në qoftë se gjithçka ecën siç duhet, mund të nënshkruhet në 2028-n, që do të thotë, varet nga procesi i ratifikimit, vizioni i qeverisë suaj dhe i qytetarëve në rast se e kam kuptuar siç duhet. Pra, Shqipëria mund të bëhet shtet anëtar në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030", ka thënë Kos.

Në vijim, Kos vlerësoi edhe përparimin e Shqipërisë në fushën e drejtësisë, duke e cilësuar sundimin e ligjit si një nga elementet më të rëndësishme të procesit të integrimit. Ajo theksoi se është bërë një punë e madhe në këtë drejtim, por tashmë sfida mbeten zbatimi i reformave në praktikë dhe garantimi i rezultateve konkrete.

Rama: Ne nuk kërkojmë dhurata, të gjitha kërkesat e BE-së do të përmbushen pikë për pikë

Nga ana tjetër, kryeministri Edi Rama u shpreh se Shqipëria ndodhet më pranë se kurrë anëtarësimit në BE, por nënvizoi se procesi nuk varet vetëm nga puna e vendit, pasi vendimi përfundimtar kërkon pajtimin e të 27 shteteve anëtare.

Në konferencën përmbyllëse të samitit, kryeministri Edi Rama tha se qeveria shqiptare nuk kërkon favore apo dhurata nga Bashkimi Evropian, por synon t'i përmbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në procesin e negociatave. "Ne nuk kërkojmë dhurata, duam maksimumin e detyrave", deklaroi Rama, duke theksuar se të gjitha kërkesat e BE-së do të përmbushen pikë për pikë. Sipas tij, këto reforma nuk bëhen thjesht sepse i kërkon Bashkimi evropian, por sepse janë të domosdoshme për të ardhmen e vendit.

Kreu i qeverisë nënvizoi se Shqipëria duhet të vijojë me të njëjtin ritëm punën për përmbushjen e kushteve, ndërsa vlerësoi se vendi ndodhet në një moment të rëndësishëm të rrugëtimit evropian.

Samiti në Tiranë u përqendrua te rezultatet e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, përshpejtimin e reformave dhe perspektiven e integrimit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shpallen "Nderi i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës"

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, të enjten në Prishtinë është mbajtur një manifestim solemn, gjatë të cilit Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë shpallur "Nderi i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës".

Gjatë ceremonisë, vëmendje e veçantë iu kushtua edhe proceseve gjyqësore në Dhomat e Specializuara të Kosovës ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë kontekst, anëtari i Kryesisë së Shoqatës dhe kryetari i Shoqërisë "Lëvizja", Xhevat Bislimi, lexoi propozimin e politologëve Bardhyl Mahmuti dhe Ramadan Avdiu.

Në propozim kërkohej që të gjithë të dënuarit nga Dhomat e Specializuara të shpallen të burgosur politikë, ndërsa Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi të shpallen edhe "Nderi i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës". Propozimi u miratua unanimisht nga të pranishmit.





FSK-JA SHËNON 27 NËNTORIN - "DITËN E FORCËS" - ME AKTIVITETE NË TË GJITHA KAZERMAT

KOSOVA SHËNON DITËN E USHTRISË

Kazerma "Adem Jashari" të premten ishte plot me qytetarë dhe fëmijë. Me rastin e "Ditës së Forcës", ata vizituan njësitë e FSK-së, biseduan me pjesëtarët e saj dhe u njohën nga afër me pajisjet dhe kapacitetet e tyre. Të pranishëm në këtë ditë ishin edhe udhëheqësit e lartë shtetërorë, të cilët theksuan se ushtria e sotme e Kosovës nuk mund të kuptohet jashtë historisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata u zotuan që do ta rritin përkushtimin për forcimin e ushtrisë, avancimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe mbështetjen e pjesëtarëve të saj

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka shënuar të premten 27 Nëntorin - "Ditën e Forcës", duke hapur dyert në të gjitha kazermat e saj, për të shënuar këtë ditë të rëndësishme për institucionin dhe pjesëtarët e saj.

Në ceremoninë qendrore të mbajtur në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë të pranishëm ishin edhe udhëheqës të lartë shtetërorë, përfaqësues institucionalë dhe mysafirë të ftuar, të cilët u pritën nga udhëheqësit e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Për t'i parë nga afër kapacitetet ushtarake, pajisjet dhe aftësitë profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, një numër i madh i nxënësve, mësimdhënësve dhe qytetarëve vizituan kazermat e FSK-së në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Istog, Mitrovicë, Pomozotin dhe Prizren.

Në këtë ditë festë për FSK-në u prezantuan zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së si dhe përkushtimi i pjesëtarëve të saj në ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe përmbushjen e misionit dhe detyrave.

Shënimi i "Ditës së Forcës" përbën një rast të veçantë për ta vlerësuar rrugëtimin dhe zhvillimin e FSK-së si dhe për ta nderuar përkushtimin dhe shërbimin e pjesëtarëve të saj në shërbim të Republikës së Kosovës.

Me rastin e Ditës së Forcës, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka uruar të gjithë personelin ushtarak dhe civil të FSK-së.

Në urimin e tij komandanti i FSK-së shpreh respekt dhe mirënjohje të sinqertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së për kontributin dhe angazhimin e pakursyer që janë duke e dhënë në shërbim të vendit. "Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë, kadetë dhe shërbyes civilë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, falë përkushtimit dhe punës suaj të palodhshme, sot jemi më të përgatitur se kurrë, duke u radhitur krah për krah me partnerët tanë në mbrojtje të paqes dhe sigurisë kudo në botë. Në këtë ditë të veçantë le të reflektojmë së bashku në të kaluarën tonë dhe t'i nderojmë sakrificat e të gjithë atyre brezave të cilët janë meritorët më të mëdhenj të lirisë të cilën e gëzojmë sot. Faleminderit të gjithëve për shërbimin ndaj atdheut dhe punën e palodhshme që jeni duke e bërë për ngritjen dhe avancimin e FSK-së! Urime Dita e Ushtrisë për ju, djem dhe vajza të shkëlqyer të ushtrisë sonë!", ka thënë ai.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci ka thënë se "Dita e Forcës" është ditë krenarie për shtetin për ushtrinë dhe për secilin me uniformën e shenjtë që i shërben atdheut me nder, përkushtim dhe profesionalizëm. Ai ka thënë se sot shënojnë jo vetëm përvjetorin e ushtrisë sonë, por edhe një kapitull të rëndësishëm të transformimit të saj. "Periudha 2021-2026 shënon vite të zhvillimit të hovshëm, investimeve historike, modernizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Përmes punës, sakrificës dhe përkushtimit tuaj, kemi bërë hapa të mëdhenj drejt ndërtimit të një ushtrie moderne, profesionale dhe të ndërveprueshme me NATO-n. Gjatë këtyre viteve kemi trefishuar buxhetin e mbrojtjes, kemi investuar rreth 500 milionë euro në armatim, rekrutuar 3 220 ushtarakë të rinj dhe trajnuar mijëra ushtarakë në akademitë e vendeve aleate. Sot ushtria jonë disponon mbi 40 lloje sistemesh armatimi, përfshirë sistemet raketore kundërtanke Javelin dhe OMTAS, artilerinë HAWKEYE, dronët Bayraktar dhe PUMA, si dhe mijëra dronë Skydagger. Kemi fuqizuar edhe kapacitetet logjistike me 35 kamionë ushtarakë Rheinmetall dhe UNIMOG - Mercedes-Benz, ndërsa dhjetëra të tjerë do t'i pranojmë gjatë vitit 2027", ka thënë Maqedonci.

Presidentja e Kosovës, Shiroka Pula, ka uruar pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me rastin e 27 Nëntorit - Ditës së Forcës. Në mesazhin e saj ajo ka shprehur mirënjohje për të gjithë burrat dhe gratë me uniformë, të cilët i shërbejnë mbrojtjes së lirisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.

Presidentja ka theksuar se Ushtria e Kosovës mishëron aspiratën e brezave për një Kosovë të lirë, të pavarur dhe të sigurt, duke rikujtuar se ajo është ndërtuar mbi sakrificën e popullit dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në cilësinë e presidentes dhe komandantes supreme, Shiroka Pula ka ritheksuar përkushtimin për forcimin e ushtrisë, avancimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe mbështetjen e pjesëtarëve të saj. Ajo ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tjerë strategjikë, me synim ndërtimin e një force moderne, profesionale dhe të ndërveprueshme me ushtritë e vendeve të NATO-s.

Në mesazhin e saj, presidentja ka përkujtuar edhe komandantin legjendar Adem Jashari, familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e kombit, duke vlerësuar sakrificën e tyre si burim frymëzimi dhe përgjegjësie. "Liria që trashëguam është amanet. Mbrojtja e saj është detyrë. Shërbimi ndaj atdheut është misioni ynë i përbashkët", ka shkruar Shiroka Pula, duke uruar 27 Nëntorin - "Ditën e Forcës".

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, me rastin e "Ditës së Forcës", ka vizituar njësitë e FSK-së në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite kryetarja Haxhiu bisedoi me pjesëtarët e saj dhe u njoh nga afër me pajisjet dhe kapacitetet e tyre.

Kryetarja e Kuvendit tha se Ushtria e sotme e Kosovës nuk mund të kuptohet jashtë historisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo theksoi se nga lufta për çlirimin e vendit kemi arritur te ndërtimi i kapaciteteve tona për mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës. "Forcimi i ushtrisë







dhe anëtarësimi në NATO mbeten prioritete strategjike të Kosovës. Me aleatët që na mbështetën në çlirimin e vendit, synojmë të jemi partnerë të barabartë në garantimin e sigurisë kolektive. Krenare me vajzat e djemtë tanë në uniformë dhe mirënjohëse për shërbimin e tyre ndaj atdheut. Urime Dita e Forcës", theksoi kryetarja e Kuvendit.

Ndërkaq ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se sot, në "Ditën e Forcës", theksojnë rëndësinë që ka anëtarësimi i Kosovës në NATO për sigurinë në Kosovë dhe rajon si dhe për paqen në botë. "Dyert e hapura sot në FSK mundësojnë të kuptojmë më shumë për jetën ushtarake dhe sukseset e vajzave dhe djemve, ndër më të mirët e atdheut, të cilët me përkushtim dhe vendosmëri janë në ballë të mbrojtjes së lirisë së fituar me gjak dhe sakrificë dhe të ruajtjes së paqes", ka thënë Haradinaj.

Ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka uruar pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e Ditës së Forcës. Çitaku ka bërë me dije se, së bashku me deputetin e PDK-së dhe ish-komandantin e FSK-së, gjeneralin Rrahman Rama, kanë kujtuar 14 dhjetorin e vitit 2018, kur Kuvendi i Kosovës votoi për transformimin e FSK-së dhe marrjen e mandatit të ushtrisë. Ajo ka rikujtuar se në atë kohë presidenti Hashim Thaçi ishte komandant suprem i Forcës.





ZBULOHET PLLAKA PËRKUJTIMORE NË SHTËPINË E SABIT GECIT NË LLAUSHË, NË PRAG TË 29-VJETORIT TË DALJES PUBLIKE TË UÇK-së

SKENDERAJ, 27 NËNTOR - Në Llaushë të Skenderajt është zbuluar një pllakë përkujtimore në shtëpinë e Sabit Gecit, në prag të shënimit të 29-vjetorit të daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në këtë shtëpi, ku janë marrë vendime të rëndësishme për daljen publike të UÇK-së, pllaka është vendosur në shenjë nderimi për historinë dhe sakrificën e luftëtarëve të lirisë.

Pjesë e këtij aktiviteti ka qenë edhe ish-komandanti i UÇK-së në Dukagjin, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se më 28 nëntor 1997, Muja, Rexha dhe Dauti e bënë publike para botës Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke shënuar një moment historik në rrugëtimin e vendit drejt lirisë. "Sot u bëmë bashkë në Llaushë, në





prag të shënimit të 29-vjetorit të daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në shtëpinë e bashkëluftëtarit Sabit Geci. Në këtë shtëpi, aty ku u morën vendime të rëndësishme për daljen publike të UÇK-së, sot morëm pjesë edhe në zbulimin e pllakës përkujtimore, në shenjë nderimi për historinë dhe sakrificën e luftëtarëve të lirisë. Më 28 nëntor 1997, ishin Muja, Rexha dhe Dauti ata që e bënë publike para botës Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke shënuar një moment historik në rrugëtimin tonë drejt lirisë. Lavdi dëshmorëve dhe të gjithë atyre që dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

63 luftëtarë të Brigadës 124 "Gani Paçarizi" nderohen me "Medaljen e Lirisë"

RAHOVEC, 27 NËNTOR - Në prag të festave kombëtare të nëntorit, kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, u ka ndarë "Medaljen e Lirisë" 63 luftëtarëve të Brigadës 124 "Gani Paçarizi", në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe sakrificën e tyre në luftën për çlirimin e Kosovës. "Në nëntorin e lavdisë, krenarisë dhe kujtesës sonë kombëtare, nga Skënderbeu e Ismail Qemali, tek Adem Jashari dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, historia jonë vazhdon e dëshmon se liria u fitua me qëndresë, gjak dhe sakrificë brezash. Me nder e krenari e bartshi Medaljen e Lirisë! Emrat, vepra dhe sakrifica juaj qofshin përherë të skalitura në kujtesën tonë dhe të nderuara brez pas brezi në historinë e kombit shqiptar. Lavdi të rënëve për liri! Nderim për të gjithë ata që i shërbyen atdheut!", ka shkruar ai në rrjetet sociale.



SI U SHTREMBËRUA DEBATI PËR SHËNDETIN RIPRODHUES DHE KODIN CIVIL NGA DEZINFORMATAT?

Në Kosovë debatet për shëndetin riprodhues dhe Kodin Civil kanë nxitur sërish kundërshtime politike dhe publike. Por, përtej qëndrimeve për dhe kundër, dallimi mes asaj që shkruhet në projektligje dhe asaj që pretendohet për to mbetet i ndjeshëm



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në një video të parë nga rreth 45 mijë persona në llogarinë e tij në "Facebook", deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Eman Rrahmani, nga salla e Kuvendit flet për Projektligjin për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar Mjekësor. Duke iu referuar nenit që parasheh mundësinë e sterilizimit të vajzave mbi 18 vjeç, me kërkesën dhe pëlqimin e tyre, ai thotë: "... Qeveria e ka futur në ligj dhe do ta bëjë obligative..."

Por, sterilizimi nuk parashihet të jetë obligativ. Neni 8 i projektligjit e parasheh sterilizimin si zgjedhje të vullnetshme. Sipas tij, vajzat mbi 18 vjeç dhe djemtë mbi 23 vjeç mund t'i nënshtrohen procedurës pa lejen e komisionit për vlerësim mjekësor. Për personat nën këto mosha, projektligji përcakton kushte të veçanta.

Megjithatë, Rrahmani nuk e ka adresuar ende gabimin në videon e publikuar në "Facebook" gjashtë ditë më parë. Kjo video është vetëm një nga rastet e debatit që është rihapur në Kosovë rreth shëndetit riprodhues, një temë që kishte nxitur kundërshtime të shumta edhe para dy vjetësh dhe ishte përcjellë me dezinformata.

"Radio Evropa e Lirë" kërkoi nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) të dijë se sa procedura të tilla janë realizuar nëpër institucionet shëndetësore publike apo private deri më tani, meqë kjo procedurë nuk është aktualisht e ndaluar.

Përkundrazi, ajo lejohet përmes disa dokumenteve ligjore dhe nuk parasheh kufizime në moshë: Ligji për Shëndetin Riprodhues, i vitit 2008, mundëson këtë procedurë për çdo individ "në përputhje me dëshirat e veta", pa paraparë kufizim në moshë; Ligji për Shëndetësi, i vitit 2013, mundëson atë për këdo që bën kërkesë individuale, "pas konsultimit mjekësor", sërish pa kufizim në moshë.

Si në Kosovë, edhe në Shqipëri projektligji për shëndetin riprodhues parasheh mundësinë e sterilizimit sipas vullnetit të lirë për vajzat mbi 18 vjeç dhe djemtë mbi 23 vjeç. Në rajon dhe botë, ky limit dallon nga 18 deri në 35 vjeç.

REL, po ashtu, kërkoi nga MSh-ja sqarime se pse projektligji parasheh kufizime të ndryshme të moshës për vajzat dhe djemtë në lidhje me sterilizimin. As për këtë nuk mori përgjigje.

Në të kaluarën debati për këtë projektligj është fokusuar te kundërshtimet që fertilizimi i asistuar mjekësor, i njohur si IVF, t'u mundësohet grave pavarësisht statusit të tyre, pra: qofshin beqare, qofshin në një çift homoseksual apo heteroseksual.

Për Blenda Asllanin, aktiviste feministe, kundërshtimet ndaj të drejtave riprodhuese dhe barazisë gjinore nuk janë vetëm debat rreth përmbajtjes së ligjeve dhe kundërshtimeve politike.

"Përmes dezinformimit, të drejtat paraqiten si kërcënim ndaj familjes, moralit apo identitetit kombëtar. Trupi dhe autonomia e grave vazhdojnë kështu të përdoren si instrument për mobilizim politik", thotë Asllani për REL-in. Sipas saj, paraqitja e të drejtave të grave si kërcënim për familjen, fëmijët apo vlerat shoqërore mund të shërbejë për ta normalizuar kufizimin e lirive të tyre dhe për ta mobilizuar elektoratin përmes frikës. "Qëllimi politik është të ruhet kontrolli mbi gratë, trupat e tyre dhe zgjedhjet që ato bëjnë për jetën e tyre", thotë ajo.

Pasojat, sipas Asllanit, nuk kufizohen vetëm te debati i momentit. Në plan afatgjatë, ky diskurs, thotë ajo, mund ta normalizojë kontrollin mbi trupat dhe vendimmarrjen e grave dhe ta bëjë më të vështirë ushtrimin e të drejtave të fituara ndër vite.

Në programin e vet, Qeveria e Kosovës ka paraparë që këtë projektligj ta vendosë për votim në Kuvend më 30 dhjetor të këtij viti.

"Radio Evropa e Lirë" e ka pyetur Qeverinë nëse ka pasur konsultime me grupet parlamentare dhe nëse ka siguruar mbështetje këtë herë për këtë ligj, por nuk ka marrë përgjigje.

Edhe Kodi Civil ka nxitur debat që kur Kuvendi i Kosovës rifilloi punën pas bllokadës institucionale të dy vjetëve të fundit. Qeveria kishte planifikuar ta miratonte më 15 nëntor, por atë ditë projektkodi ishte ende në konsultim publik.

Ky projektkod ka 1 630 nene dhe rregullon jetën e qytetarëve të Kosovës nga pronësia e trashëgimia deri te detyrimet në marrëveshjet familjare. Por, kur u publikua për konsultim publik që përfundoi më 16 nëntor, qindra qytetarë e kundërshtuan duke u fokusuar te pjesa që rregullon martesat dhe bashkësitë civile.

Kodi Civil parasheh martesë vetëm mes burrit dhe gruas, por regjistrim të bashkësive civile edhe ndërmjet personave të së njëjtës gjini. Në debat kjo dispozitë është paraqitur si lejim i martesave mes personave të së njëjtës gjini.

Edhe kur Kodi Civil u diskutua për herë të parë në Kuvend, dallimi mes martesës dhe bashkësisë civile u bë temë debati mes kryetarit të atëhershëm të Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe disa deputetëve të koalicionit qeverisës, përfshirë Eman Rrahmanin, atëherë deputet i Lëvizjes Vetëvendosje.

Kundërshtimet fokusoheshin te pretendimet se njohja e bashkësive civile mes personave të së njëjtës gjini po shkatërronte "institucionin e familjes" dhe kishin përfshirë edhe dezinformata të ndryshme për mënyrën se si marrëdhëniet e tilla ndikojnë në shëndet publik.

Ky projektkod tashmë ka tejkaluar afatin e paraparë nga Qeveria për miratim, që ishte më 15 nëntor. Ende nuk dihet se kur do të dërgohet në Kuvend.

Miratimi i tij është një nga kushtet e Agjendës së Reformave të Kosovës në kuadër të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian. Sipas dokumentit zyrtar të kësaj agjende, për këtë reformë janë paraparë rreth 9.4 milionë euro. Nëse Kosova nuk e përmbush këtë hap brenda afatit të përcaktuar, rrezikon të mos i përfitojë këto mjete.

KUVENDI I KOSOVËS EMËRON KËSHILLIN KOMBËTAR TË SHKENCËS

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar 15 anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës të propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilët do të kenë mandat katërvjeçar.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku, gjatë prezantimit të propozimit në Kuvend, vlerësoi rëndësinë e funksionalizimit të Këshillit Kombëtar të Shkencës për zhvillimin, koordinimin dhe avancimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. "Kjo listë përfshin fusha të ndryshme të dijes dhe të veprimtarisë shkencore, duke synuar përfaqësimin e një spektri të gjerë të ekspertizës akademike dhe kërkimore-shkencore. Kjo përbërje e propozuar përfshin një pjesë të anëtarëve nga përbërja e Këshillit të kaluar për të siguruar vazhdimësinë, si dhe garanton diversitetin e fushave të studimit, përfaqësimin adekuat të institucioneve të dijës, fushave priotare të shkencës sipas Programit Kombëtar të Shkencës, si dhe respektimin e parimit të përfaqësimit të balancuar gjinor", deklaroi ministri Çeku.

Anëtarët e emëruar dhe fushat që përfaqësojnë janë:

Aliriza Arenliu - Psikologji
Arbnora Dushi - Folkloristikë
Armond Daci - Farmakologji
Arven Syla - Energjetikë
Besnik Krasniqi - Ekonomi dhe Ndërmarrësi
Emine Kalaja-Hajdari - Histori
Fetah Podvorica - Elektrokimi
Ibrahim Krasniqi - Ekonomi dhe Menaxhim
Majlinda Bregasi - Gjuhësi
Mentor Alishani - Veterinari
Mihone Kerolli-Mustafa - Inxhinieri Mjedisore
Mimoza Ibrani - Telekomunikacion
Myzafere Krasniqi-Limani - Elektronikë
Tringa Dedi - Pedagogji;
Valmir Krasniqi - Matematikë.



Kuvendi i Shqipërisë miraton buxhetin prej 10 miliardë eurosh për vitin 2027

TIRANË, 27 NËNTOR - Pas disa orësh debatesh të ashpra, përplasjesh politike dhe replikash mes mazhorancës dhe opozitës, Kuvendi ka miratuar me 80 vota për dhe 20 kundër buxhetin e shtetit për vitin 2027, i cili këtë vit ka kaluar pragun historik të 10 miliardë eurove. Po ashtu, është miratuar edhe Paketa Fiskale, me pesë projektligjet që e përbëjnë, të cilat parashikojnë ndryshime dhe shtesa në legjislacionin tatimor të vendit.
Të gjitha amendamentet e opozitës janë rrëzuar.
Seanca plenare është shoqëruar me një klimë të tensionuar politike, ku në qendër të diskutimeve kanë qenë jo vetëm projektbuxheti dhe ndryshimet fiskale, por edhe aktet normative të qeverisë për tubimet, të cilat kanë shkaktuar debate të forta mes palëve politike.
Deputetët e opozitës e kanë kundërshtuar ashpër paketën antidhunë, duke e cilësuar atë përpjekje për ta kufizuar të drejtën kushtetuese për protestë.
Në të njëjtën kohë, mazhoranca e ka mbrojtur nismën e qeverisë, duke argumentuar se masat synojnë parandalimin e akteve të dhunës dhe mbrojtjen e institucioneve, pronës publike dhe private.
Një prej momenteve më të rëndësishme të seancës ka qenë edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e dispozitës që parashikon gjobën prej 5 mijë lekësh për bllokimin e rrugëve gjatë protestave. Ky vendim është bërë shkak për replika të forta mes deputetëve të opozitës dhe kreut të Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, lidhur me kompetencat e Kuvendit për vijimin e shqyrtimit të akteve normative. Gjatë diskutimeve nuk kanë munguar as përplasjet personale. Sali Berisha është përfshirë në replika me ministrin e Kulturës, Blendi Gonxhja, ndërsa debat ka pasur edhe me deputetin socialist Erion Braçe.
Nga ana tjetër, Ulsi Manja ka shkëmbyer akuza me kreun e Partisë Mundësia, Agron Shehaj, dhe deputetin Erald Kapri.
Pavarësisht prej tensioneve dhe kundërshtimeve të opozitës, mazhoranca ka vijuar procedurën parlamentare deri në votimin e projektbuxhetit dhe Paketës Fiskale për vitin 2027. Në momentin e votimit të buxhetit,



kryeministri Edi Rama nuk ka qenë i pranishëm në sallën e Kuvendit. Miratimi i tyre me shumicë votash shënon përmbylljen e një prej proceseve më të rëndësishme parlamentare të këtij viti, ndërsa debati politik pritet të vijojë edhe në ditët në vazhdim.

MINISTRAT THEKSOJNË RËNDËSINË E PRODHIMIT VENDOR NË HAPJEN E 'JAVËS SË BIZNESIT KOSOVAR 2026'

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka hapur "Javën e Biznesit Kosovar 2026", me moton "Unë konsumoj produkte vendore, po ju?", duke bërë thirrje për mbështetjen e prodhimit vendor, fuqizimin e bizneseve, rritjen e eksporteve dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Në aktivitetin ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve dhe komunitetit të biznesit, është theksuar rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat për zhvillimin ekonomik të Kosovës.
Nënkryetarja e Kuvendit, Emilija Rexhepi, ka vlerësuar punën e AKB-së, duke thënë se krijimi i kushteve më të mira për bizneset, nxitja e investimeve, zvogëlimi i barrierave burokratike dhe mbështetja e prodhimit vendor duhet të jenë përgjegjësi e përbashkët institucionale.
Ndërsa ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar se AKB-ja për 24 vjet me radhë ka kontribuar në promovimin e prodhimit vendor. Ajo ka bërë me dije se institucionet po punojnë në skema grantesh për certifikimin e produkteve, mekanizma të rinj financiarë përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe krijimin e parqeve industriale, me qëllim të rritjes së prodhimit dhe konkurrueshmërisë së bizneseve.



Kurse ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, ka thënë se bujqësia në Kosovë ka shënuar rritje prej 60-përqindësh gjatë katër viteve të fundit. Ai ka theksuar se vendi ka potencial për rritjen e prodhimit të mishit, pemëve dhe perimeve, duke nënvizuar nevojën për tejkalimin e barrierave të eksportit.
Muja ka bërë me dije se Kosova importon çdo vit pemë dhe perime në vlerë prej 100 deri në 150 milionë euro. Sipas tij, ndër prioritetet e ministrisë janë zgjerimi i prodhimit gjatë gjithë vitit, investimet në sera dhe krijimi i kapaciteteve të magazinimit dhe zinxhirit të ftohjes, për ta ruajtur vlerën e produkteve bujqësore. Në anën tjetër, ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli-Dalipi, ka theksuar rëndësinë e përmbushjes së standardeve mjedisore dhe përgatitjes së bizneseve për kërkesat e tregut evropian. Ajo ka paralajmëruar se kompanitë eksportuese duhet të përgatiten për zbatimin e mekanizmave të taksimit të karbonit dhe të kenë të dhëna të verifikuara për emetimet. Sipas saj, institucionet po përmbyllin pakon ligjore për sistemin e matjes dhe verifikimit të emetimeve. Më tutje, ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq, ka vënë në pah rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe komuniteteve të ndryshme, duke theksuar potencialin ekonomik të veriut të Kosovës. Përmes "Javës së Biznesit Kosovar 2026" AKB-ja synon ta rrisë vetëdijen e konsumatorëve për rëndësinë e blerjes së produkteve vendore, duke theksuar se kjo i ndihmon prodhuesit, punëtorët, familjet dhe ekonominë e vendit.

NDËRTIMI NË KOSOVË VAZHDON TË SHTRENJTOHET, RRITET KOSTOJA E TRANSPORTIT, E PAGAVE DHE E MATERIALEVE

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kostoja e ndërtimit në Kosovë është rritur për 6.1 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2026 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Indeksi i Kostos së Ndërtimit ka shënuar rritje për 1.4 për qind krahasuar me tremujorin e dytë të këtij viti.
Rritja më e madhe në nivel vjetor



është regjistruar te transporti me 13.1 për qind, pasuar nga pagat me 9.7 për qind, kostot e tjera me 7.3 për qind, materialet ndërtimore me 5.4 për qind dhe energjia me 3.3 për qind. Kategoria e vetme që ka shënuar rënie është ajo e makinerive, 0.6 për qind.
Krahasuar me tremujorin paraprak, rritja më e madhe është regjistruar tek energjia 4.9 për qind, pagat 3.3 për qind, transporti 1.7 për qind, kostot e tjera 1.4 për qind dhe materialet 1.1 për qind. Te makineritë është regjistruar rënie 0.4 për qind.

Kostoja e ndërtimit, mbi 60 për qind më e lartë se në vitin 2015

Të dhënat e ASK-së tregojnë se Indeksi i Kostos së Ndërtimit ka arritur në 160.7 pikë në tremujorin e tretë të vitit 2026, niveli më i lartë që nga fillimi i serisë statistikore më 2013. Krahasuar me vitin bazë 2015, kostot e ndërtimit janë rritur për 60.7 për qind. Tendenca e rritjes së kostove është përshpejtuar veçanërisht nga viti 2021. Në vitin 2021 rritja mesatare vjetore ishte 12.2 për qind, ndërsa më 2022 arriti në 20.1 për qind. Në vitin 2023 rritja mesatare vjetore ishte 0.6 për qind, më 2024 arriti në 3.4 për qind, ndërsa më 2025 në 4.4 për qind.
Gjatë vitit 2026 rritja në nivel vjetor ka vazhduar të përshpejtohet, nga 4.3 për qind në tremujorin e parë, në 5.1 për qind në të dytin dhe 6.1 për qind në tremujorin e tretë.

Ministri Muja thotë se ka rritje të prodhimit dhe eksporteve

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, ka paraqitur të dhënat për mbështetjen e sektorit të bujqësisë gjatë periudhës 2021-2026, duke bërë me dije se përmes granteve dhe subvencioneve janë ndarë rreth 350 milionë euro. Në një postim në "Facebook", ministri ka thënë se gjatë këtij mandati janë regjistruar rreth 150 mijë përfitime nga fermerët.
Sipas të dhënave të publikuara prej tij, pagesat direkte për bujqësinë janë rritur për 103 për qind, nga 36.7 milionë euro në vitin 2020, në 74.7 milionë euro në vitin 2025. Ai ka bërë me dije se vlera e prodhimit bujqësor është rritur për 52.6 për qind, nga 779.5 milionë euro, në 1.19 miliard euro, ndërsa eksportet bujqësore, sipas tij, kanë shënuar rritje prej 152-përqindësh, nga 73.9 milionë euro, në 186.6 milionë euro.
Ministri Muja ka përmendur edhe mbështetjen për tokën bujqësore dhe blegtorinë, duke bërë me dije se gjatë vitit 2025 janë subvencionuar 130 mijë e 310 hektarë tokë bujqësore, apo 97 për qind më shumë krahasuar me vitin 2021.
Ndërkohë, sipas tij, janë financuar 103 stalla moderne për zhvillimin e blegtorisë. Muja ka theksuar edhe mbështetjen nga partnerët ndërkombëtarë, e cila, sipas të dhënave të publikuara, ka arritur në 51 milionë euro, apo 184 për qind më shumë krahasuar me periudhën 2018-2021. Ai ka treguar se 11 milionë euro janë ndarë për 5 mijë e 655 gra fermere përmes granteve dhe subvencioneve.
Një tjetër çështje që ka përmendur ministri është kthimi i pronave të uzurpuara në pronësi të shtetit, përmes të cilit, sipas tij, është parandaluar një dëm prej mbi 500 milionë eurosh. "Investimi në bujqësi është investim në ekonominë e



vendit, në sigurinë ushqimore dhe në mirëqenien e familjeve tona", ka shkruar ministri Muja.
Ai e ka përfunduar postimin duke theksuar se synimi është më shumë mbështetje për fermerët, rritje të prodhimit vendor dhe një sektor bujqësor më konkurrues.

RAPORTI ALARMUES: RUSIA DYSHOHET SE PO PËRGATIT LËSHIMIN E NJË SATELITI ME ARMË BËRTHAMORE NË HAPËSIRË

Rusia thuhet se po përgatitet të lëshojë në hapësirë një satelit të pajisur me armë bërthamore më vonë këtë vit, në një skenar që mund të përbëjë një kërcënim të rëndësishëm për komunikimet globale.
Mediat gjermane kanë raportuar, duke cituar vlerësimet e agjencive perëndimore të inteligjencës, se një satelit i tillë mund të lançohet brenda 60 ditësh dhe do të jetë funksional menjëherë pas kësaj.



Çfarë thotë raporti?

Një raport nga transmetuesit gjermanë NDR dhe WDR dhe gazeta Suddeutsche Zeitung tha se shërbimet perëndimore të inteligjencës, përfshirë shërbimin e inteligjencës Bundesnachrichtendienst (BND) të Gjermanisë dhe forcat e armatosura, kishin shkëmbyer informacione që tregonin se një satelit me energji bërthamore, i quajtur Sputnik-S, ishte montuar disa vjet më parë dhe është i stacionuar në rajonin e Moskës.
Mund të lançohet këtë vit. Një zëdhënës i qeverisë gjermane tha se po i merrte raportet e inteligjencës "shumë seriozisht".

Çfarë ndikimi mund të ketë një pajisje bërthamore nëse shpërthen në orbitë?

Në hapësirë, ku nuk ka atmosferë. Në vend të kësaj, energjia nga një shpërthim bërthamor çlirohet si rrezatim. Një shpërthim do të ishte veçanërisht i dëmshëm në orbitën e ulët të Tokës, ose deri në 1,900 milje mbi Tokë, ku veprojnë shumica e satelitëve.
Jonathan McDowell, një astrofizikan dhe profesor nderi në Qendrën e Kërkimeve Hapësinore të Universitetit Durham në Mbretërinë e Bashkuar, tha se efektet kryesore ishin të dyfishta.
Sipas tij. çdo gjë brenda vijës së shikimit të shpërthimit mund të shkatërrohej nga rrezet X dhe format e tjera të rrezatimit të cilat mund të rrëzonin ose dëmtonin satelitët brenda mijëra miljeve.
Së dyti, ai shtoi se grimcat e rrezatimit mund të emetoheshin në atmosferën e poshtme dhe të formonin një "rrip Van Allen" të ri, termi për dy rripa rrezatimi që rrethojnë Tokën dhe e mbrojnë atë nga ndikimi i stuhive diellore.
Do të ishte një përsëritje e një ngjarjeje në vitin 1962 kur SHBA-të shpërthyen një bombë termonukleare 250 milje mbi sipërfaqen e Tokës – në orbitën e ulët të Tokës – në një ngjarje të quajtur Starfish Prime. Kishte shumë më pak satelitë atëherë, por kjo shkurtoi jetën e dy anijeve: satelitëve Telstar 1 dhe Ariel-1.
"Ylli i detit shkaktoi rrezatim të rëndë gjatë një periudhe muajsh në të paktën gjysmën e satelitëve që ishin në orbitë në atë kohë, të cilët nuk ishin shumë në atë kohë", tha McDowell për "The Guardian".
Keith Ryden, profesor i inxhinierisë hapësinore në Universitetin e Surrey në Mbretërinë e Bashkuar, tha se satelitët në orbitën e ulët të Tokës ishin të prekshëm ndaj shpërthimeve të rrezatimit.
"Meqenëse nivelet natyrore të rrezatimit janë relativisht të ulëta në këtë rajon, satelitët e vendosur atje nuk janë projektuar për nivele të larta rrezatimi, kështu që do të ishin të ndjeshëm ndaj rritjeve të papritura", tha ai.

Cila është zona më dëmtuese e orbitës që kjo të ndodhë?

Në orbitën e poshtme të Tokës ndodhen rreth 17,000 satelitë, duke përfshirë satelitë të rëndësishëm për parashikimin e motit, monitorimin e klimës dhe ushtrinë, si dhe rrjetin e satelitëve të Elon Musk që formojnë rrjetin e internetit me brez të gjerë Starlink. Ky i fundit është thelbësor për të ndihmuar përpjekjet e Ukrainës në zmbrapsjen e pushtimit të Rusisë.
Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor, në të cilin Rusia është partnere, është gjithashtu në orbitën e ulët të Tokës. Konstelacioni i propozuar i qendrave të të dhënave hapësinore nga Musk do të operonte gjithashtu atje.
Satelitët që trajtojnë transmetimet televizive, GPS-in dhe komunikime të tjera janë në orbita më të larta, të cilat janë më pak të lehta për t'u prekur nga një armë bërthamore.

Sa kohë do të duhej për të rikuperuar aktivitetin në zonën e prekur të orbitës?

McDowell tha se brezi artificial Van Allen i shkaktuar nga Starfish Prime ekzistonte prej pesë vitesh.
"Do të ketë ndikime të menjëhershme nga një shpërthim, por ka efekte afatgjata mjedisore që do të dëmtojnë satelitët në planin afatgjatë. Mund të duhen disa vite, deri në një dekadë, që grimcat e bllokuara të shpërndahen nga brezi i rrezatimit", tha ai.
Ryden shtoi: "Po aq e rëndësishme, industria hapësinore nuk do të kishte kapacitetin për të rindërtuar dhe lëshuar numrin e kërkuar të anijeve kozmike në një kohë të shkurtër."

A do të ndikohej menjëherë aktiviteti në Tokë nga një shpërthim?

Qindra milje poshtë shpërthimit të Starfish Prime, dritat e rrugëve në Hawaii u fikën, alarmet kundër vjedhjeve u ndezën në zonë dhe thirrjet telefonike u ndërprenë.
"Mund të ketë një ndikim në kompjuterët dhe sistemet elektronike në rajonin e tokës ku shpërthimi është i dukshëm", tha McDowell.
Ryden shtoi se testet bërthamore Starfish dhe teste të tjera bërthamore u zhvilluan në zona me popullsi të pakët, kështu që vendndodhja e shpërthimit ishte thelbësore.
Starfish Prime krijoi gjithashtu efekte mahnitëse të aurorës, ndërsa qielli u ndriçua në nuanca të gjelbra, të verdha, të kuqe dhe, sipas një raporti, "ylbere të bardhë të jashtëzakonshëm".
"Do të kishte efekte të mëdha auroral. Nuk do të ishte diçka delikate. Është e vështirë të jesh delikate me armët bërthamore", tha McDowell.

A ka gjasa Rusia të shpërthejë një bombë bërthamore në hapësirë?

Një zyrtar evropian i sigurisë i tha gazetës The Guardian se ata dyshonin se Rusia do të shpërthente një pajisje bërthamore në hapësirë. Ata thanë se kjo mund të shkaktonte dëme të konsiderueshme në ekonomitë perëndimore, por se do të dëmtonte ndjeshëm edhe Rusinë.
Një shpërthim i tillë do të ishte i vështirë për t'u kontrolluar dhe ndoshta do të dëmtonte satelitët e Rusisë, si dhe potencialisht edhe ata të Kinës.
"Do të ishin si të qëllonin veten në këmbë", thanë ata.
Ata vunë në dukje shantazhin bërthamor të Rusisë më herët gjatë luftës së saj në Ukrainë, përfshirë kur Rusia i vuri forcat e saj bërthamore në gatishmëri të lartë në vitin 2022, e ndjekur nga lëvizjet e trupave dhe armëve.
McDowell tha se ishte skeptik në lidhje me Rusinë që shpërtheu një armë bërthamore në hapësirë, sepse ishte "një ide kaq budallaqe" të kryente atë që do të shihej si një akt lufte.

“TSUNAMI BLU” TRAZON MARRËDHËNIET E TRUMP-IT ME ALEATËT E TIJ NË BALLKAN

Përshëndetje nga Uashingtoni, ku republikanët në Kongres dhe Presidenti Donald Trump kanë hyrë në fazën e fundit të mandatit të tyre politik, pas disfatës së thellë që u shkaktoi i ashtuquajturi “tsunami blu”. Demokratët siguruan shumicën në të dyja dhomat e Kongresit, madje edhe në shtete që prej dekadash kanë qenë bastione republikane, si Teksasi, Kansasi dhe Misisipi. Të zhgënjyer nga rritja e çmimeve të karburanteve dhe ushqimeve, si pasojë e luftës në Iran, dhe të indinjuar nga pasurimi i Presidentit dhe i njerëzve të rrethit të tij të ngushtë, votuesit i besuan demokratëve.

Zgjedhjet e mesmandatit u shndërruan në një referendum për Presidentin, por Trump nuk e pranon përgjegjësinë për humbjen e thellë të republikanëve dhe vazhdon të mbajë një qëndrim sfidues. Përplasja me demokratët duket e pashmangshme. Sapo këta të marrin zyrtarisht kontrollin e Kongresit në janar, paralizimi i politikës së brendshme në Uashington duket pothuajse i sigurt. Në politikën e jashtme, ndërkaq, Kongresi mund të ndjekë një linjë të ndryshme nga ajo e Shtëpisë së Bardhë. Dhe kjo mospërputhje mund të ketë pasoja edhe për Ballkanin.

Me formimin e qeverisë së re në Serbi, administrata amerikane duket se synon të vazhdojë në të njëjtën rrugë. Madje, pa u konstituuar ende parlamenti i ri serb, Departamenti i Shtetit ndërmori një nismë të rëndësishme, duke dërguar në Beograd zyrtarin më të lartë përgjegjës për rajonin. Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, Brendan Hanrahan, u takua me përfaqësues të Listës Studentore, e cila doli fituese në zgjedhje. Takimi u zhvillua në të njëjtën ditë kur përfaqësuesit e kësaj liste u takuan edhe me ambasadorin rus në Serbi.

Përveç mesazheve tashmë të njohura për rifillimin e Dialogut Strategjik dhe thellimin e partneritetit mes dy vendeve, në agjendën e bisedimeve SHBA-Serbi u përfshi edhe një çështje e re: bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar. Kjo është gjithashtu një nga fushat që qeveria e ardhshme serbe ka deklaruar se do ta ketë përparësi.

Megjithatë, Kongresi amerikan mund të ketë prioritete të tjera, nëse Ballkani do të arrijë të zërë një vend në agjendën e tij. Në një mesazh urimi drejtuar udhëheqjes së re të Serbisë pas zgjedhjeve, një grup senatorësh nga të dyja partitë, anëtarë të Komisionit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë, riafirmuan angazhimin e SHBA-së për integrimin evropian të Serbisë, forcimin e institucioneve demokratike dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Pra, Kongresi duket i gatshëm të mbështesë njërën prej objektivave



kryesore të qeverisë së re serbe: integrimin evropian të vendit. Por mbetet për t’u parë se si do të pritet kjo qasje në Shtëpinë e Bardhë, e cila aktualisht ndodhet në një marrëdhënie të tensionuar me Brukselin.

Një tjetër çështje që mbetet e paqartë është se çfarë marrëdhënieje do të krijojnë me Trump-in përfaqësuesit e Listës Studentore, një lëvizje pa lider, që synon të çrrënjosë korrupsionin. Trump, nga ana tjetër, e trajton politikën si një çështje transaksionesh dhe është akuzuar nga kritikët për korrupsion dhe favorizim të njerëzve të afërt me të.

Qeveria e mëparshme, e drejtuar nga Aleksandër Vuçiç dhe Partia Progresive Serbe, SNS, kishte marrëdhënie të mira me Trump-in. Ajo u ofroi mundësi biznesi anëtarëve të familjes së Presidentit amerikan dhe pagoi lobistë me lidhje me të, për të punuar në interes të Serbisë. Megjithatë, raportimet treguan se puna e tyre përqendrohej më shumë në promovimin e Vuçiçit dhe aleatëve të tij.

Konservatorët amerikanë mblidhen në Beograd

Përpjekjet e Serbisë për të krijuar lidhje me Trump-in dhe të djathtën amerikane nuk kanë qenë krejtësisht të kota. Edicioni i parë ballkanik i Konferencës së Veprimit Politik Konservator, CPAC, forumi më me ndikim që mbledh konservatorët amerikanë dhe aleatët e tyre ndërkombëtarë, do të zhvillohet në Beograd.

Pas humbjes së pushtetit nga Vuçiçi, CPAC e kishte shtyrë organizimin e aktivitetit të saj në Ballkan, por tashmë e ka caktuar sërish datën: 27 janar, në Beograd. Vuçiçi nuk do të jetë më folësi kryesor, por do të marrë pjesë në konferencë. Sipas njoftimit për shtyp të CPAC, ftesa do t’u dërgohen edhe përfaqësuesve të shumicës së re qeverisëse.

Data e re e konferencës u bë publike pas një takimi të mbyllur që CPAC organizoi në Mar-a-Lago, pas zgjedhjeve të mesmandatit. Aktiviteti kishte karakter komercial, me bileta që kushtonin nga 2,500 dollarë për një darkë deri në 95,000 dollarë për një përvojë ekskluzive në prapaskenë. Zeljko Mitroviç, pronari i televizionit Pink TV, një media e afërt me Vuçiçin, mburrej në llogarinë e tij në rrjetin X se kishte marrë pjesë në konferencë dhe kishte ndjekur edhe një fjalim jozyrtar të Trump-it.

CPAC financohet pjesërisht nga shitja e biletave për aktivitete të tilla, por ende nuk dihet se kush qëndron financiarisht pas konferencave që organizohen jashtë SHBA-së. CPAC organizohet nga Unioni Konservator Amerikan, një organizatë jofitimprurëse, e cila nuk është e detyruar t’i bëjë publikë emrat e donatorëve të saj.

Megjithatë, konservatorët amerikanë mund të jenë e vetmja familje politike ndërkombëtare me të cilën Vuçiçi dhe partia e tij ruajnë ende lidhje, pasi Partia Populllore Evropiane, PPE, ka njoftuar se SNS-ja ndodhet në prag të përjashtimit nga radhët e saj.

Një shembull i suksesshëm i krijimit të lidhjeve me konservatorët amerikanë është Milorad Dodik, ish-presidenti i entitetit me shumicë serbe në Bosnjë, Republika Srpska. Edhe ai pagoi një biletë për të marrë pjesë në takimin e CPAC në Mar-a-Lago. Dodik ka arritur të krijojë marrëdhënie të afërta me qarqet amerikane falë miliona dollarëve që ka paguar për lobistë të lidhur me Trump-in, përfshirë bashkëpunëtorë të fushatës së tij dhe vajzën e ish-shefit të kabinetit të Presidentit amerikan.

Por Dodik duket se ka pasur edhe një aleat në Departamentin e Shtetit. Media me bazë në Uashington, Semafor, publikoi një artikull për Alexander Alden, këshilltar i Marco Rubio-s, i cili më herët ishte përshkruar jozyrtarisht si personi që drejtonte në prapaskenë politikën amerikane ndaj Bosnjës.

Sipas Semafor, Alden ishte shprehur në favor të përmirësimit të marrëdhënieve me Dodikun dhe të reduktimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi Bosnjën, përfshirë edhe rolin e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë. Pas dorëheqjes së Christian Schmidt, pasardhësi i tij në këtë detyrë ende nuk është emëruar.

Trump e ka emëruar Alden-in ambasador të SHBA-së në Azerbajxhan. Nëse procesi i konfirmimit të emërimit të tij vijon, në Senat ka të ngjarë t’i bëhen pyetje edhe për qëndrimin e tij ndaj Republikës Srpska.

Qasja miqësore ndaj Dodikut mund të përballet me pengesa kur demokratët të marrin kontrollin e Kongresit në janar. Anëtarë të të dyja partive në Kongres kanë kërkuar rikthimin e sanksioneve ndaj Dodikut për shkak të retorikës së tij separatiste, si dhe kanë ngritur shqetësime për skemën e tij të ndikimit politik përmes pagesave, të njohur si “pay-to-play”. Megjithatë, pushteti ekzekutiv i ka shpërfillur me sukses këto kërkesa. Nëse Ballkani do të përfshihet në agjendën e Kongresit, Dodiku ka të ngjarë të jetë ndër çështjet e para që do të shqyrtohen.

Edhe Kosova i drejtohet lobimit në Uashington

Edhe Kosova ka vendosur të provojë ndikimin e lobistëve për të përmirësuar pozicionin e saj në rrethin e afërt të Trump-it. Për këtë qëllim, ajo ka angazhuar një kompani të njohur lobimi, të drejtuar nga Brian Ballard, një strateg dhe mbledhës fondesh me përvojë në radhët e republikanëve. Shefja e mëparshme e kabinetit të Trump, Susie Wiles, dhe ish-prokurorja e përgjithshme Pam Bondi kanë punuar dikur në kompaninë Ballard Partners. Gjatë fushatës presidenciale të vitit 2024, Ballard ishte një nga mbledhësit kryesorë të fondeve për Trump-in. Pavarësisht disa mosmarrëveshjeve të herëpashershme me Presidentin, ai gëzon reputacion të mirë në Shtëpinë e Bardhë.

Sipas marrëveshjes, Kosova do t’i paguajë kompanisë 50 mijë dollarë në muaj për të lobuar në një sërë çështjesh, duke filluar nga komunikimi publik e deri te promovimi i interesave të saj gjeopolitike. Kjo është hera e parë në dy vjet që Prishtina angazhon zyrtarisht një kompani amerikane për ta ndihmuar në gjetjen e gjuhës së përbashkët me administratën Trump. Kjo e fundit pezulloi Dialogun Strategjik, ndërsa marrëdhëniet me partnerin e saj më të afërt në Ballkan janë përkeqësuar ndjeshëm.

Kosova ka mbetur gjithashtu pa ambasador amerikan prej gati dy vitesh. Megjithatë, kjo situatë mund të ndryshojë së shpejti. Në nëntor, Trump propozoi Mikhail Bogachek, nga Florida, drejtues i një organizate të Organizatës së Shteteve Amerikane, për postin e ambasadorit në Prishtinë. Bogachek ka doktoraturë në bioinxhinieri, por nuk ka përvojë as në diplomaci dhe as në çështjet e Ballkanit. Ai është anëtar i bordit drejtues të Koalicionit Hebraik Republikan, një organizatë lobuese që ndër të tjera synon forcimin e marrëdhënieve me Izraelin.

Sipas të dhënave të disponueshme në regjistrat publikë, Bogachek është gjithashtu drejtues i organizatës jofitimprurëse Federata Ruso-Amerikane. Megjithatë, biografia e tij nuk përmend ndonjë prejardhje ruse.

Edhe posti i ambasadorit amerikan në Maqedoninë e Veriut mund të plotësohet më në fund. Për këtë detyrë është propozuar Christy McCormick, një avokate nga Kalifornia, e cila ka një karrierë të gjatë në Komisionin Amerikan për Asistencën Zgjedhore. Ajo ka qenë gjithashtu pjesë e komisionit të ngritur nga Trump pas fitores së zgjedhjeve të vitit 2016, me synimin për të hetuar pretendimet për manipulime zgjedhore, pasi Hillary Clinton fitoi votën popullore.

McCormick tërhoqi vëmendjen në SHBA edhe në vitin 2025, kur publikoi një deklaratë në mbështetje të një teorie konspirative të promovuar nga Trump, sipas së cilës demokratët kërkojnë kufij të hapur, në mënyrë që emigrantët pa dokumente të hyjnë në vend dhe të votojnë për ta.

Arsyet që çuan në përzgjedhjen e McCormick për të përfaqësuar SHBA-në në Shkup mbeten të paqarta. Megjithatë, ajo ka dëshmuar besnikëri politike, një cilësi që Trump e vlerëson mbi të gjitha kur zgjedh personat që do të shërbejnë në administratën e tij.

Emërimet e ambasadorëve amerikanë në Serbi, Bosnjë dhe Mal të Zi kanë bërë një hap tjetër drejt miratimit përfundimtar. Komisioni i Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë i ka përcjellë kandidaturat e Michael K. Young, Ronald Johnson dhe Peter McCoy për votim në Senatin e plotë, i cili mund të zhvillohet deri në fund të vitit. Gjatë kësaj periudhe të fundit të mandatit, ndërsa republikanët vazhdojnë të kenë shumicën në Kongres, ata do të përpiqen të miratojnë sa më shumë nisma nga agjenda e Trump-it.

Megjithatë, situata nuk është aq e thjeshtë. Ndonëse republikanët e kanë ende shumicën, bëhet fjalë për një sesion të fundit të Kongresit përpara ndryshimit të përbërjes së tij. Për më tepër, nevoja për miratimin e buxhetit pritet t’i ndërlikojë ndjeshëm gjërat dhe të kërkojë kompromise politike mes palëve. Në Capitol Hill, emërimet presidenciale që i përcillen Senatit për miratim janë përdorur tradicionalisht si karta negociuese. Një gjë është e sigurt: duhet të përgatitemi për pasiguri.

SHIROKA PULA NË OHËR: KOSOVA NUK KËRKON PRIVILEGJ, POR BARAZI DHE RESPEKT NË RRUGËN DREJT BE-së

Faton DËRMAKU



SHKUP, 27 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Justina Shiroka Pula, ka marrë pjesë për herë të parë në Samitin e liderëve të rajonit, në kuadër të Procesit Brdo-Brijuni, që po mbahet në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Në fjalimin e saj, presidentja ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, integrimit evropian dhe trajtimit të barabartë të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ajo ka shprehur shqetësimin për mospërfshirjen e Kosovës në Forumin e Zgjerimit të Bashkimit Evropian, të mbajtur më 16 nëntor në Bruksel, duke kritikuar edhe lejimin e mesazheve nacionaliste që, sipas saj, vënë në pikëpyetje shtetësinë dhe integritetin territorial të Kosovës. "BE-ja nuk mund të ndërtojë unitet duke toleruar simbole dhe praktika që nxisin ndarje, por as të mjaftohet me një distancim formal", ka deklaruar Shiroka Pula. Ajo ka theksuar se Kosova nuk kërkon privilegj, por barazi, respekt dhe trajtim të drejtë, duke shtuar se integrimi evropian është zgjedhje strategjike dhe orientim i qartë shtetëror i vendit.

Presidentja ka kërkuar përparim më të shpejtë të Kosovës drejt statusit të vendit kandidat në BE, duke vlerësuar se zvarritja e këtij procesi dëmton besimin e qytetarëve në perspektivën evropiane.

Në fjalimin e saj, Shiroka Pula ka folur edhe për rëndësinë e integrimit ekonomik rajonal, zbatimin e Planit të Ritjes dhe heqjen e tarifave të roamingut ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor.

Duke iu referuar situatës së sigurisë në Evropë pas agresionit rus në Ukrainë, ajo ka theksuar se Kosova ka investuar në fuqizimin e kapaciteteve të saj mbrojtëse, në personel, pajisje dhe armatim, me synim garantimin e integritetit territorial dhe kontributin në sigurinë e përbashkët me aleatët.

Në përmbyllje të fjalimit, presidentja ka shprehur gatishmërinë e Republikës së Kosovës për të qenë nikoqire e takimit të ardhshëm të Procesit Brdo-Brijuni. Ajo ka vlerësuar se një takim i tillë në Kosovë do ta forconte dialogun dhe bashkëpunimin rajonal si dhe përkushtimin e përbashkët ndaj integrimit evropian.

Marrëdhëniet e veçanta ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të përkthehen në bashkëpunim konkret

Në kuadër të takimit të liderëve të Procesit Brdo-Brijuni, Shiroka Pula ka takuar presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Presidentja Shiroka Pula theksoi se Kosova dhe Shqipëria kanë lidhje të veçanta, të rrënjosura në histori, gjuhë, kulturë dhe ndjenjën e përkatësisë së përbashkët. Ajo nënvizoi se nuk ka asgjë që i ndan dy shtetet, të cilat janë një zemër, një mendje dhe një komb, të bashkuara nga e njëjta frymë në të dyja anët e kufirit. Ajo shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë ndaj Kosovës dhe theksoi se forcimi i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve është përgjegjësi e përbashkët, që duhet të udhëhiqet nga aferësia dhe vullneti për të ndërtuar së bashku të ardhmen.

Në takim u diskutua edhe për orientimin strategjik të të dyja vendeve.

Presidentja Shiroka Pula theksoi se anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe integrimi në Bashkimin Evropian mbeten ndër prioritetet kryesore të vendit. Në këtë drejtim, ajo vlerësoi përvojën e Shqipërisë si anëtare e NATO-s dhe përparimin e saj në procesin e integrimit evropian, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit më të ngushtë si dhe të shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy vendeve.

Presidentja Shiroka Pula vlerësoi se marrëdhëniet e veçanta ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të vazhdojnë të përkthehen në bashkëpunim konkret në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Ajo theksoi se Shqipëria është vendi me të cilin Kosova ka nënshkruar numrin më të madh të marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit, një pjesë e konsiderueshme e të cilave tashmë po zbatohen.



Vlerësohet mbështetja sllovene për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

Në kuadër të takimit të liderëve të Procesit Brdo-Brijuni, që po mbahet në Ohër, presidentja e Republikës së Kosovës, Shiroka Pula, takoi presidenten e Republikës së Sllovenisë, Natasa Pirc Musar.

Presidentja Shiroka Pula vlerësoi rëndësinë e Procesit Brdo-Brijuni, të iniciuar nga Sllovenia dhe Kroacia, në mbështetje të bashkëpunimit rajonal dhe integrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Ajo rikujtoi se Kosova është pjesë e këtij procesi që nga viti 2013, kur u mbajt takimi i parë në Sllloveni.

Gjatë takimit presidentja Shiroka Pula theksoi se orientimi euroatlantik i Kosovës mbetet i palëkundur dhe se vendi është plotësisht i përkushtuar ndaj agjendës evropiane. Ajo nënvizoi rëndësinë që procesi i integrimit në BE të bazohet në merita dhe ta vlerësojë përparimin dhe reformat e secilit vend.

Presidentja theksoi se, krahas përshpejtimit të reformave dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal, anëtarësimi i Kosovës në NATO mbetet prioritet strategjik dhe synim kryesor në fushën e sigurisë.

Presidentja Shiroka Pula shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Sllovenisë ndaj Kosovës. Ajo vlerësoi në veçanti mbështetjen sllovene për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe theksoi rëndësinë e vazhdimit të këtij angazhimi deri në përmbylljen e procesit.

Në takim u diskutuan edhe mundësitë për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit ekonomik, si dhe rritjes së shkëmbimeve tregtare.

Edhe dy banka nisin zbatimin e sistemit të pagesave të shpejta në Kosovë TIPS-K

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se, sipas planit, TIPS-K po zgjerohet me pjesëmarrjen e dy bankave të reja: Ziraat Bank dhe PriBank. Me këto dyja rritet në gjashtë numri i bankave që operojnë në TIPS-K: ProCredit Bank, Banka për Biznes, Raiffeisen Bank, NLB Banka, Ziraat Bank dhe PriBank. "Bankat e tjera do t'i bashkohen sistemit gradualisht dhe në vijimësi, pas përfundimit të përgatitjeve të nevojshme teknike dhe operative, brenda periudhës kalimtare tremujore, e cila përfundon më 23 shkurt 2027", ka njoftuar BQK-ja.





sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Egnatia shënon fitoren e parë në Ligën e Konferencës

TIRANË, 27 NËNTOR - Egnatia ka shënuar fitoren e parë të këtij edicioni në Ligën e Konferencës. Kampionia e Shqipërisë ka triumfuar ngushtë, me rezultat 2:1, në shtëpi ndaj ekipit nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps. Pjesa e parë është mbyllur pa gola, kurse e dyta ka nisur me gol. Ishte Albanese ai që ka realizuar në minutën e 47 të ndeshjes. Rezultati është barazuar nga Flalhi Idrissi në minutën e 79, kurse vetëm dy minuta më vonë Fernando Medeiros e ka rikthyer epërsinë e rro-gozhinasve dhe ia ka siguruar fitoren ekipit të vet. Me këtë triumf, Egnatia është ngjitur përkohësisht në vendin e 20, me pesë pikë të grumbulluara.



SHORT "FERRI" PËR SHQIPËRINË NË EURO U21, DUKA E QUAN HISTORIK ORGANIZIMIN

BEOGRAD, 27 NËNTOR - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, e ka cilësuar Kampionatin Evropian U21, që do të organizohet vitin e ardhshëm nga Shqipëria dhe Serbia, ngjarje historike për futbollin shqiptar.

Duka ka mbajtur një fjalim përshëndetës në ceremoninë e hedhjes së shortit për fazën finale të këtij kompeticioni, duke shprehur kënaqësinë për mundësinë që Shqipëria të jetë nikoqire e një prej ngjarjeve më të rëndësishme të futbollit evropian për ekipet kombëtare. Ai ka theksuar se ky Evropian do të ketë rëndësi të veçantë edhe për përfaqësuesen shqiptare U21, e cila për herë të parë do të marrë pjesë në një turne të tillë, duke u përballur me disa prej kombëtareve më të mira të kontinentit. "Për ekipin tonë kombëtar është hera e parë që marrim pjesë në një event të tillë të rëndësishëm. Është hera e parë që futbollistët tanë të rinj do të përballen me më të mirët e Evropës. Uroj që të marrin eksperiencën e duhur dhe ta shfrytëzojnë këtë moment historik për karrierën e tyre futbollistike", ka deklaruar Duka.

Ndërkohë në ceremoninë e mbajtur në Beograd është hedhur edhe shorti për fazën finale të Euro U21 2027, ku Shqipëria është vendosur në Grupin B, së bashku me Spanjën, Italinë dhe Finlandën.



Një grup mjaft sfidues për kuqezinjtë, të cilët do të kenë përballë dy prej kombëtareve më të forta të Evropës në këtë grupmoshë. Grupet e tjera përbëhen nga Portugalia, Kroacia, Greqia dhe Çekia në Grupin C, ndërsa në Grupin D janë Gjermania, Holanda, Norvegjia dhe Belgjika. Kampionati Evropian do të zhvillohet nga 16 qershori deri më 3 korrik 2027, në Shqipëri dhe Serbi. Ndeshjet në Shqipëri do të luhen në Tiranë, Elbasan dhe Shkodër, ndërsa në garë do të marrin pjesë 16 përfaqësuese, të ndara në katër grupe. Dy skuadrat e para të secilit grup do ta sigurojnë kualifikimin në çerekfinale. Për Shqipërinë ky turne përfaqëson një mundësi të veçantë për të luajtur para tifozëve të vet dhe për të fituar përvojë në nivelin më të lartë të futbollit evropian për grupmoshat U21.

Grupet e Euro U21 2027:
Grupi A: Serbia, Anglia, Franca, Polonia
Grupi B: Shqipëria, Spanja, Italia, Finlanda
Grupi C: Portugalia, Kroacia, Greqia, Çekia
Grupi D: Gjermania, Holanda, Norvegjia, Belgjika

SUNDERLANDI IA ZGJAT KONTRATËN GRANIT XHAKËS DERI NË VITIN 2029

SUNDERLAND, 27 NËNTOR - Klubi anglez ka aktivizuar një opsion që nuk ishte bërë publik në momentin e transferimit të mesfushorit nga Bayer Leverkuseni. Marrëveshja e re e mban kapitenin e Sunderlandit në klub deri në verën e vitit 2029.

Granit Xhaka do të jetë pjesë e Sunderlandit edhe për disa sezone të tjera. Klubi anglez ka aktivizuar një klauzolë të kontratës së mesfushorit shqiptar, e cila nuk ishte bërë publike në kohën kur ai u transferua nga Bayer Leverkuseni.

Sipas mediumit anglez "The Echo", i cili është i afërt me klubin, drejtuesit e Sunderlandit e kanë aktivizuar opsionin për zgjatjen e kontratës në fund të sezonit të kaluar, duke e shtyrë atë deri në verën e vitit 2029. Ky detaj merr rëndësi të veçantë në kontekstin e interesimit të Chelseat për shërbimet e Xhakës gjatë verës së kaluar.



Sipas raportimit, në atë periudhë mesfushori kishte ende tri vjet kontratë me Sunderlandin. Chelsea thuhet se kishte arritur një marrëveshje në parim me futbollistin për kushtet personale, por klubi nga Sunderlandi nuk ishte i gatshëm ta lironte kapitenin e tij. "The Echo" raporton gjithashtu se Sunderlandi kishte refuzuar disa oferta në vlerë prej rreth tetë milionë funtesh për mesfushorin, i cili fillimisht kishte shprehur interesim për një rikthim në Londër.

Ndërkohë, Xhaka aktualisht është në fazën e rikuperimit nga lëndimi i pësuar në ndeshjen kundër Chelseat, në fillim të këtij muaji. Paraqitja e tij e 50 me fanellën e Sunderlandit ka përfunduar pas vetëm katër minutash, pasi ai është detyruar të largohet nga fusha për shkak të lëndimit.

GUARDIOLA: ASKUSH NGA GJENERATA E RE NUK MUND TA ARRIJË NIVELIN E MESSIT

SANTIAGO, 27 NËNTOR - Ish-trajneri i Barcelonës, Bayern Munichut dhe Manchester Cityt, Pep Guardiola, i është përgjigjur një pyetjeje nëse ndonjë lojtar i gjeneratës së re mund të barazohet me Lionel Messin. Messi është drejt fundit të karrierës së tij si futbollist, por ka lënë gjurmë të pashlyeshme në histori, duke fituar tetë Topa të Artë, si dhe shumë trofe të tjerë, përfshirë La Ligën, Copa del Rey, Superkupën e Spanjës, Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës, Copa American dhe Kupën e Botës. Kjo trashëgimi e lënë në futboll ka bërë që, sipas ish-trajnerit të tij, Guardiolës, asnjë lojtar i gjeneratës së re të mos mund ta arrijë nivelin e tij.



"Askush, ka shumë të mirë, por nuk shoh askënd që arrin atë nivel; duke perfo-rmuar në një standard kaq të lartë çdo tre ditë për 15 deri në 20 vjet, dhe nuk mendoj se do ta bëjë ndonjëherë. Ka rekorde që njerëzit thanë se nuk do të thyheshin kurrë, por ato përfundimisht po thyhen. Edhe rekordet e Usain Bolt do të thyhen një ditë, por të ruash atë nivel loje për kaq shumë vjet… thjesht nuk e shoh", ka thënë Guardiola për emisionin "Romario TV".

Messi vazhdon të shkëlqejë edhe në moshën 39-vjeçare, pasi këtë sezon me Inter Miamin ka shënuar 29 gola dhe ka regjistruar 16 asistime në 35 ndeshje në të gjitha garat me klubin amerikan.

Neville: Haaland brenda 18 muajve bëhet lojtar i Real Madridit

LONDËR, 27 NËNTOR - Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, Gary Neville , është i bindur se Erling Haaland do të largohet nga Manchester City për t'u transferuar te Real Madridi brenda 18 muajve të ardhshëm. Gjatë një paraqitjeje në podcastin "Stick to Football", pjesë e emisionit "The Overlap", Neville ka shkuar edhe më larg, duke parashikuar se transferimi i sulmuesit norvegjez në kryeqytetin spanjoll mund të realizohet që në fund të këtij sezoni. "Jam absolutisht i bindur se Erling Haaland do të jetë lojtar i Real Madridit brenda 18 muajve më së shumti, ndoshta edhe në fund të këtij sezoni", ka deklaruar Neville.

Ish-futbollisti anglez ka parashikuar ndryshime të mëdha në repartin ofensiv të madrilenëve për t'i krijuar hapësirë Haalandit. Sipas tij, Vinicius Junior do të largohet nga Real Madridi, Kylian Mbappe do të zhvendoset në krahun e majtë, ndërsa sulmuesi norvegjez do ta marrë pozitën e qendërsulmuesit. Një dyshe Mbappe-Haaland në sulmin e



Real Madridit do të përbënte një prej kombinimeve më të frikshme në futbollin evropian.





NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "CFC Menxhiqi " SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 812408682 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "CFC Menxhiqi" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 812408682 ujedno imenovao Likvidatora o spravodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "CFC Menxhiqi" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business NUI: 812408682 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES